



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:242079
Datë: 08.04.2024
Numri i dokumentit: 05556536

C-IV-14-3064

Ankuesi

F G, Fshati Z, Prizren
Përfaqësuar nga Av: B I,

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 08 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ017-0004/0068, i datës 10 mars 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 18 prill 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRZ017-0004/0068, të datës 10 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për paga të pa paguara, në shumë prej 102.00 Euro, për periudhën prej 01 korrik 1999 deri me 19 dhjetor 2005 nga NSH “NIN Ramiz Sadiku” (në likuidim). Ankuesi pohoi se ai dhe punëtorëve tjerë u është ndërprerë në mënyrë masive kontrata e punës nga ndërmarrja dhe se rrjedhimisht të gjithë ata kanë të drejtë në paga të pa paguara, AKP-ja nuk ua kishte mohuar këtë por AKP-ja i kishte refuzuar këto kërkesa duke pretenduar se kërkesa e tyre ishte e parashkuar. Më tej, ankuesi pohoi se punëtorëve kurdoherë që ata kanë kërkuar sqarime u është thënë se të gjitha kërkesat duhet ti paraqesin vetëm pas shpalljes së likuidimit ashtu që ata e kanë kuptuar se nuk mundën dhe nuk duhet të bëhet asgjë deri në ditën e shpalljes së likuidimit. Sipas ankuesit

është e padiskutueshme se ai ishte i punësuar aty për një kohë të gjatë deri sa AKM-ja ua ndërpret kontratat e punës të gjithë punëtorëve. Si provë ankuesi ka dorëzuar, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e vendimit të kundërshtuar, kopjen e letërnjoftimit dhe autorizimin për përfaqësim.

Me 30 shtator 2015, ankuesi parashtrori parashtrësë për plotësimin e ankesës/padisë, me të cilën kërkoi që të miratohet në tërësi si e bazuar ankesa/padia dhe të obligohet AKP-ja dhe AL-ja, që në emër të pagesës së pagave të pa paguara ti paguaj ankuesit **F G** shumën e borxhit 102.00 Euro dhe kamatën ligjore.

Me 23 mars 2023, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se AL-ja ka bërë vlerësim të saktë rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se shprehimisht e kundërshton si ekzistencën ashtu edhe lartësinë e detyrimit të pretenduar dhe thekson rregullin bazik të procedurës kontestimore sipas të cilit pala kërkuese ka detyrimin dhe barrën e provës. Po ashtu, e paditura pohoi se ankuesi nuk ka dhënë asnjë detaj të punës së tij konkrete gjatë periudhës për të cilën kërkon të shpërblehet me rroga, ai nuk ka treguar as oraret e punës, as vendin e punës, as funksionet konkrete të kryera prej tij e as ndonjë detaj tjetër që do të lejonte konstatimin se ankuesi e ka përmbushur pjesën e tij të marrëdhënies së punës duke punuar pranë NSH-së. Më tej, e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashtruar dhe se afati i parashkrimit nuk e lejon AL-në dhe DHPGJS-në të analizojë dhe shqyrtojë themelin e rastit, pretendimet e paraqitura në ankesë nuk janë të mbështetura në dëshmi dhe fakte materiale që do të ishin relevante për rastin konkret.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen

faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH-ja i ka mbetur borxh pagat e kërkuara, po ashtu ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante edhe pas dorëzimit të parashtresës për plotësimin e ankesës/padisë. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për pagat e pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e objektit të kontestit është nën 1,000.00 Euro.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare